

Ekskluzive

Ekskluzive | Bastiset banesa e një të dënuari në Prishtinë, Policia gjen armë në tarracë



Sinjali.com

30 Qershor 2026 22:30



Policia e Kosovës ka bastisur një banesë në Prishtinë pas dyshimeve se një person, i njohur për përfshirje në disa vepra penale, posedonte armë pa leje, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se aksioni është zhvilluar në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, te objekti “Aura Dent”, pas informacioneve se Valon Jashari posedonte armë zjarri.

Në momentin e bastisjes, i dyshuari nuk ndodhej në banesë, pasi sipas deklarimit të të dashurës së tij, R. D., rreth 31-vjeçar, ai është duke vuajtur dënimin në Burgun e Dubravës dhe pritet të lirohet gjatë ditës ose një ditë më vonë.

Gjatë kontrollit të banesës, Policia ka gjetur dhe sekuestruar një pistoletë të markës “Zoraki” dhe një karikator, të cilat ishin të fshehura në tarracën e banesës.

Për bastisjen është përpiluar procesverbal, ndërsa me urdhër të Prokurorit kompetent është iniciuar rasti për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Në cilësinë e dëshmitares është intervistuar R. D, ndërsa për Valon Jasharin është lënë fletëthirrje për t’u paraqitur në intervistë pas lirimit të tij nga vuajtja e dënimit.

Shënim: Personat e përmendur në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të vërtetohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Euro 2024
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera